



**VENDIM**

**Nr. 69, Datë 1.07.2013**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PER RINOVIMIN E LICENSËS SË  
FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR ELEKTRIKE TË SHOQËRISË  
“GEN – I TIRANA” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45, pika 3 dhe 4 te Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa g, nenit 8, nenit 10, pika 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshem dhe rinovimit te licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 1.07.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k., për rinovimin e licensës se furnizuesit te kualifikuar te energjise elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave per rinovimin e licenses shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit te kualifikuar te energjise elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Sokol RAMADANI**